



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KOLONJË
DREJTORIA E SHËRBIMIT SOCIAL
ZHVILLIMIT DHE EDUKIMIT TË FËMIJËVE

PROJEKT-VENDIM

Nr. Datë .2026

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.101, DATË 05.08.2026, "PËR
MIRATIMIN E TARIFËS VENDORE MUJORE FIKSE PËR FREKUENTIMIN NË
ÇERDHE DHE KOPSHTIN ME DREKË, NË KOPSHTIN NR.2 "MARIE GJERGO",
ERSEKË".**

Në mbështetje të nenit 8, nenit 23 pika 12, nenit 54, shkronja "k" dhe shkronja "f", të Ligjit Nr. 139 /2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", neni 14, neni 18, neni 21, neni 28 pika 2, nenit 28 pika 4, të ligjit Nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, Vendimit nr.662 datë 8.10.2014 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kritereve dhe procedurave për hapjen dhe mbylljen e institucioneve arsimore parauniversitare publike", pika 2 e vendimit 632, datë 04.10.2004 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e dokumentit për politikën e decentralizimit në sektorin e arsimit parauniversitar". Urdhri Nr. 76/1, datë 24.01.2018 "Për miratimin e ndryshimeve në menutë ushqimore të çerdheve dhe kopshteve për fëmijet 0-6 vjeç", i ndryshuar me Urdhin Nr.457, datë 13.06.2018 për hapjen e kopshtit me dreke në godinën e kopshtit ekzistues "Afërdita Kole" Ersekë, vendimin nr. 20, datë 17.07.2025 "Për disa ndryshime në vendimin nr.90, datë 31.08.2023 "Për miratimin e funksionit të kopshtit me drekë në godinën e kopshtit nr.1 Afërdita Kole, Ersekë, në godinën e kopshtit nr. 2 "Marie Gjergo", Ersekë". Me propozim të Kryetarit të Bashkisë Kolonjë, Drejtoria e Shërbimit Social, Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve, i kërkon Këshillit Bashkiak të miratojë në mbledhjen e datës _____:

PROPOZOI:

1. Të miratojë tarifën për frekuentimin në çerdhe dhe kopshtin me drekë.
2. Tarifa mujore të jetë: 4500 lekë nga të cilat 1500 lekë tarifë mirëmbajtje dhe 3000 lekë detyrim mujor për ushqimin.
3. Për zbatimin e këtij projekt-vendimi ngarkohet Drejtoria e Edukimit dhe Zhvillimit të Fëmijëve dhe administrata e Bashkisë Kolonjë.
4. Ky projekt- vendim hyn në fuqi pas miratimit në Këshillin Bashkiak.

Konc: Drejtori D.S.H.S.Z.H.E.F.E. Dake
Konfirmoi: Drejtori D.Ç.J.P.P O.Lifo





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KOLONJË
DREJTORIA E SHËRBIMIT SOCIAL
ZHVILLIMIT DHE EDUKIMIT TË FËMIJËVE

Nr. 5421 prot.

Datë 21.8.2026

RELACION
PËR
PROJEKT-VENDIM
Nr. _____ Datë _____ / _____ /2026

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.101, DATË 05.08.2026, "PËR
MIRATIMIN E TARIFËS VENDORE MUJORE FIKSE PËR FREKUENTIMIN NË
ÇERDHE DHE KOPSHTIN ME DREKË, NË KOPSHTIN NR.2 "MARIE GJERGO",
ERSEKË".**

Të nderuar!

Në mbështetje të nenit 8, nenit 23 pika 12, nenit 54, shkronja "k" dhe shkronja "f", të Ligjit Nr. 139 /2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", neni 14, neni 18, neni 21, neni 28 pika 2, nenit 28 pika 4, të ligjit Nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, Vendimit nr.662 datë 8.10.2014 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për hapjen dhe mbylljen e institucioneve arsimore parauniversitare publike", pika 2 e vendimit 632, datë 04.10.2004 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e dokumentit për politikën e decentralizimit në sektorin e arsimit parauniversitar". Urdhri Nr. 76/1, datë 24.01.2018 "Për miratimin e ndryshimeve në menutë ushqimore të çerdheve dhe kopshteve për fëmijet 0-6 vjeç", i ndryshuar me Urdhin Nr.457, datë 13.06.2018 për hapjen e kopshtit me dreke në godinën e kopshtit ekzistues "Afërdita Kole" Ersekë, vendimin nr. 20, datë 17.07.2025 "Për disa ndryshime në vendimin nr.90, datë 31.08.2023 "Për miratimin e funksionit të kopshtit me drekë në godinën e kopshtit nr.1 Afërdita Kole, Ersekë, në godinën e kopshtit nr. 2 "Marie Gjergo", Ersekë". Në Drejtorinë e Shërbimit Social, Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve, ju informojmë:

Për funksionimin e shërbimit në çerdhe dhe kopshtin me drekë është vlerësuar tarifa e mirëmbajtjes dhe tarifa e ushqimit të fëmijëve frekuentues në masën 4500 (katërmijë e pesëqind) lekë në muaj, nga të cilat 1500 lekë tarifa e mirëmbajtjes, ku përfshihet: shërbime në materiale bazë për përdorim të përbashkët, mirëmbajtja e ndërtesës, oborrit dhe pajisjeve elektrike, hidraulike, materialet e pastrimit dhe dizinfektimit, shpenzime për energji elektrike, ujë, ngrohje, internet, riparim dhe mirëmbajtje e lodrave dhe materialeve didaktike, lysterje, riparime dhe punime periodike në objekt, kjo e ardhur vjen si tarifë për balancimin e shpenzimeve, për shërbimet e sipërcituara, midis të ardhurave nga tarifa dhe buxhetit të bashkisë të përcaktuar për këto shërbime dhe të ardhurave nga tarifa mujore.

Tek 3000 lekë tarifa e ushqimit për fëmijë, përfshin: ngrënien e vakteve të mëngjesit, drekës dhe zemrës që gatuhet në kuzhinën e kopshtit me furnizim ditor, sipas menuve të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe me gramaturë sipas moshës së fëmijëve në çerdhe dhe kopsht. Tarifa vendoset e njëjtë edhe për fëmijët e çerdhes dhe të kopshtit, duke qenë se veprojnë në të njëjtën godinë, edhe pse çerdhja mund të ketë një ndryshim të mundshëm të kostos të shpenzimit të ushqimit sipas grupmoshës, tarifa kompenson mirëmbajtjen e përbashkët të ambienteve. Nga tarifa bëjnë përjashtim ditët e festave zyrtare, fundjavat dhe ditët kur mbyllet institucioni, ndërsa për ditët kur fëmija mungon për shkaqe të ndryshme tarifa do paguhet e plotë pasi programimet bëhen më herët në kohë sesa konfirmimi i prezencave ditore të fëmijëve.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

Konc: Drejtori D.SH.S.ZH.E.F E. Dake
Konfirmoi: Drejtori D.C.J.P.P O.Lifo

